



DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË
UPRAVA ZA POLJOPRIVREDU
DEPARTMENT OF AGRICULTURE

Tel/Fax: 0290 322 922
Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

DATA/DATUM/DATE	19.04.2024
BR/NR/BR	zyrtare
PËR/ZA/TO	Tabelën e shpalljeve
PËRMES/PREKO/THROUGH	
GA/OD/FROM	z. Burim Bajrami Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë
LANDA/PREDMET/SUBJECT	Thirrje për aplikim

Thirrje për aplikim

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë e Komunës së Ferizajt në përkrahje të zhvillimit të bletarisë për vitin 2024 shpallë Thirrjen për aplikim për projektin: **Furnizimi i bletarëve me sistemin - paisjet mbrojtëse të bletishteve nga kafshët e egra.**

Me realizimin e këtij projekti bletarët përfitues do të paisen me rrethojën elektrike të kompletuar me të gjitha paisjet e nevojshme për funksionim efikas kundër kafsheve të egra.

Përfitues do të jenë fermerët që i plotësojnë këto kritere:

- Të jetë banor i komunës së Ferizajt;
- Bletishtën ta ketë në teritorin e komunës së Ferizajt;
- Bletishtet që janë të vendosura rrezë maleve dhe që janë të rrezikuara nga kafshët e egra;
- Bletishtja duhet të ketë minimumi 30 zgjoje bletësh,
- Duhet të ketë aplikuar për subvencione për vitin 2024,
- Fermerët mund të jenë përfitues vetëm për një bletishte.

Vërejtje : Kompetentët nga Drejtoria e Bujqësisë do t'i vizitojnë të gjitha bletishtet për të cilat aplikojnë bletarët.

Për të dhëna të pasakta do të refuzoheni

Fermerët e interesuar do të aplikojnë në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve – Komuna e Ferizajt.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Certifikatën e bashkësisë familjare
- Fletëaplikacioni i plotësuar se bashku me deklaratën nën betim për vendodhjen e bletishtës (që mirret në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve);
- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Dëshminë katastrale për pronësinë (fletën poseduese origjinale jo më të vjetër se 6 muaj) të vendit ku do të vendoset sistemi mbrojtës ose marreveshjet për qeranëtë kësaj hapsire.
- Dëshminë – kopjen e aplikacionit që keni aplikuar për subvencione – Pagesa Direkte për vitin 2024;

Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim fillon nga data 19.04.2024 deri më 29.04.2024